



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

**th ë r r e t**

mbledhjen e **gjashtë** të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më **04.09.2023** dhe do të fillojë në orën **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjeve të jashtëzakonshme dhe mbledhjes së pestë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Raporti i punës së kryetarit të Kryeqytetit për gjashtëmuajorin e parë të vitit 2023;
3. Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e Kodit të etikës, për anëtarët e Kuvendit komunal të Prishtinës;
4. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe Plani i veprimit të menaxhmentit;
5. Propozimvendimi për faljen tatimore për vitin tatimor 2023;
6. Propozimvendimi për miratimin e raportit nr.14-050/01-85379/23, dt. 28.04.2023 të komisionit profesional për verifikimin dhe vlerësimin e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale;
7. Propozimvendimi për miratimin e raportit nr.14-020/04-0171429/23, dt. 15.04.2023 të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit dhe të statusit të banesave në Bregun e Diellit, Fushën e Pajtimit dhe në Hajvali;
8. Propozimvendimi për miratimin e raportit nr. 14-050/01-85384/23, dt. 28.04.2023 të komisionit profesional për verifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale në Zonën Industriale;
9. Propozimvendimi për plotësim - ndryshimin e Vendimit nr. 01-462/01-134225/23,

- të dt. 29.06.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë;
10. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Shemsi (Rifat) Begollit;
  11. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Alping SH.P.K;
  12. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, me pronën e paluajtshme në pronësi të Delta Invest SHPK;
  13. Draftregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës së organizatave të biznesit në Komunën e Prishtinës, 01.nr.110-1203, dt. 16.06.2010;
  14. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Mati 1", për bllokun "A-11" në Prishtinë;
  15. Propozimvendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Prishtina e Re-Zona Perëndim", për pjesën e banimit individual – njësitë hapësinore " I,L,G në Prishtinë;
  16. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për groposjen e kafshëve me sëmundje infektive në fshatin Bërnice e Epërme, në Prishtinë;
  17. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Prishtina International Film Festival – Prifest;
  18. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për shoqatën për kultivimin e artit skenik "Sythi";
  19. Propozimvendimi për ndarjen e mjeteve financiare për Gran Fest – Kosova;
  20. Pyetje dhe përgjigje;
  21. Të ndryshme.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT**  
01-060/01-174917/23, më 23.08.2023

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
Pëllumb Bajcinoçi

